

VENDIM
Nr. 1155, datë 24.12.2020

PËR KRITERET PËR PËRCAKTIMIN E NJËSISË SË VETËQEVERISJES
VENDORE, TË NUMRIT THELBËSOR DHE TË KËRKESËS SË MJAFTUESHME
TË PERSONAVE TË PAKICAVE KOMBËTARE PËR T'U ARSIMUAR NË
GJUHËN E PAKICËS KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 13, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Personat që i përkasin një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare në institucione arsimore të caktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin.

2. Në institucionet arsimore ekzistuese, ku gjuha e arsimimit është gjuha shqipe, nxënësit e një pakice kombëtare kanë të drejtë të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare që i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, sipas kurrikulave e programeve të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.

3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, numri thelbësor dhe kërkesa me qëllim sigurimin e së drejtës për t'u arsimuar në gjuhën e pakicës kombëtare përcaktohen në bazë të kriterëve të mëposhtme:

a) numri i personave që i përkasin pakicës kombëtare, i cili duhet të jetë jo më pak se 20 (njëzet) për qind e numrit të përgjithshëm të banorëve të njësisë administrative, si nënndarje e bashkisë;

b) periudha e regjistrimit si banor në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas periudhave të regjistrimit të popullsisë, konfirmuar me vërtetim të lëshuar sipas të dhënave nga regjistrat themeltarë të gjendjes civile dhe/ose Regjistrat Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010;

c) kërkesa shkresore, paraqitur nga prindër apo kujdestarë të fëmijëve që i përkasin pakicës kombëtare, pranë bashkisë/njësisë administrative, ku shprehet vullneti në mënyrë shkresore dhe bazuar në të drejtën e vetidentifikimit për formimin e klasës.

4. Numri i nxënësve që u përkasin pakicave kombëtare, që kanë të drejtën të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare së cilës i përkasin, si dhe të studiojnë historinë, traditat dhe kulturën e tyre, duhet të jetë jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) nxënës për klasë, në bazë të kërkesës shkresore nga prindërit apo kujdestarët, sipas përcaktimit në shkronjën “c”, të pikës 3, të këtij vendimi.

5. Administrimi i informacionit për verifikimin e plotësimit të kriterëve të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, bëhet nga prefekti i qarkut. Pas verifikimit të përmbushjes së kriterëve, prefekti përcakton njësitë e vetëqeverisjes vendore, në të cilat personave që i përkasin një pakice kombëtare do t'u sigurohet e drejta të arsimohen në gjuhën e pakicës kombëtare.

6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat janë përcaktuar sipas pikës 5, të këtij vendimi, kanë të drejtën e nismës për hapjen e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare, në përputhje me parashikimet ligjore për krijimin e funksionimin e klasave në gjuhën e pakicave kombëtare.

7. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Brendshme, prefekti i qarkut dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe